



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM  
Nr. 10 datë 26.2.2020

PËR  
MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME  
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS  
FINANCIARE PËR FAMILJEN E ZNJ. BEHIJE KASAJ, Z. BERHAN MUÇA, Z.  
GLITON DIBRA BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI.

Këshilli i Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e datës 26.2.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, neni 54, shkronja ”dh”, ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr.26, datë 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2020-2022 të Bashkisë Shkodër”, Shkresa me Nr. 3950 prot., datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër, me 35 vota pro,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së Znj. **Behije Kasaj** (3 anëtarë familje), në vlerën prej 60 000 lekë (gjashtëdhjetë mijë ), për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e Znj. **Behije Kasaj** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 423 831 lekë (katërqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e një), dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 299 700 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e Znj. **Behije Kasaj**.

3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së Z. **Berhan Muça** (4 anëtarë familje), në vlerën prej 80 000 lekë tetëdhjetë mijë), për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e Z. **Berhan Muça** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 215 810 lekë (tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind e dhjetë), dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 93 320 (nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzet) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e Z.**Berhan Muça**.
5. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së Z. **Gliton Dibra** (2 anëtarë familje), në vlerën prej 40 000 lekë (dyzet mijë lekë), për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
6. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e Z. **Gliton Dibra** në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 340 331 lekë (treqind e dyzet mijë e treqind e tridhjetë e një), dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 213 600 (dyqind e trembëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind) lekë, sipas preventivave të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e Z.**Gliton Dibra**.
7. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile parashikuar në programin P03280 “ Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2020 të miratuar me VKB nr 26. datë 30.12.2019, në programin P03280, O1 A2 “ Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 180 000 lekë.
8. T'i paraqesë dokumentacionin përkatës dhe t'i kërkojë mbështetje Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, Ministrisë Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjen e **Znj.Behije Kasaj, Z.Berhan Muça, Z.Gliton Dibra**, sipas përcaktimeve të VKM -së Nr. 329 datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë/pamjaftueshmeri së Bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
9. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër për likuidimin e shumës prej 180 000 lekë (njëqind e tetëdhjetë mijë )lekë.
10. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
11. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**Sekretar i Këshillit**

  
Denis Leshja

**KRYETARE**

